**Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut** parashikon dënime për cenimin e sigurisë dhe pengimin e një zyrtari në kryerjen e detyrës zyrtare, gjë që mund të zbatohet edhe në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, duke marrë parasysh rolin e tyre me interes publik. Për më tepër, janë parashikuar edhe dispozita që inkriminojnë diskriminimin në baza të shumta – duke përfshirë gjininë dhe seksin – si dhe vepra penale të urrejtjes, të cilat janë të motivuara nga paragjykimet dhe stereotipat, duke përfshirë ato në bazë të gjinisë dhe identitetit gjinor.

Është e rëndësishme të theksohet se përkufizimet dhe kualifikimet ligjore për këto vepra penale janë zgjeruar ndjeshëm për të përfshirë kryerjen e veprave penale edhe përmes mjeteve digjitale ose informatike, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e sulmeve dhe ngacmimeve online në rritje me të cilat përballen gazetaret.

## — 5.4 KORNIZA LIGJORE PËR DHUNËN ME BAZË GJINORE

Maqedonia e Veriut ratifikoi **Konventën e Stambollit (KS)** në vitin 2018, e cila është marrëveshja më gjithëpërfshirëse ndërkombëtare për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave. Si rezultat i këtij ratifikimi, në vitin 2019 u miratua **Ligji për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje**, i cili jep një përkufizim të dhunës me bazë gjinore, si dhe përkufizime të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, të cilat në pjesën më të madhe janë në përputhje me përkufizimet e dhëna në Konventën e Stambollit.

Raporti i parë nga Grupi i Ekspertëve për Monitorimin e Zbatimit (GREVIO) thekson angazhimin e vendit për zbatimin e KS-së përmes miratimit të Ligjit për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, si dhe ndryshimet në Kodin Penal që kriminalizojnë ngacmimin seksual dhe ndjekjen.

Në kontekstin e kësaj analize, është veçanërisht e rëndësishme që GREVIO përmend **gazetaret si një kategori specifike të cënueshme ndaj dhunës**, veçanërisht ndaj gjuhës së urrejtjes mizogjene, kërcënimeve dhe ngacmimit në hapësirën digjitale. GREVIO shpreh shqetësim për pasivitetin e institucioneve në mbrojtjen e gazetareve, duke përfshirë edhe situatat kur dhuna është raportuar nga një gazetare që ka përjetuar një lloj të caktuar dhune. Prandaj, GREVIO rekomandon që të përfshihet perspektiva gjinore në marrjen e masave të nevojshme për të avancuar sigurinë e gazetarëve dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje e paarsyeshme në punën e tyre. Për të parë dhe dëgjuar perspektivat e grave në media, institucionet duhet të reagojnë menjëherë ndaj raporteve të gazetareve që janë shënjestër sulmesh për shkak të gjinisë dhe profesionit të tyre<sup>35</sup>.

### 5.4.1 KODI PENAL

Kodi Penal përmban një përkufizim të veçantë për dhunën me bazë gjinore, duke njohur specifikën dhe seriozitetin e kësaj forme dhune. Në këtë drejtim, Kodi përfshin disa vepra penale specifike të lidhura me dhunën me bazë gjinore, siç janë sulmi seksual, ngacmimi seksual, përndjekja, dhuna në familje dhe forma të tjera të dhunës ndaj grave. Megjithatë, Kodi Penal nuk parashikon një vepër penale të veçantë për dhunën ndaj gazetareve, as një dënim më të rëndë nëse veprat penale që lidhen me format specifike të dhunës me bazë gjinore kryhen ndaj gazetareve.

35 GREVIO – Raporti Themelor i Vlerësimit për Maqedoninë e Veriut, paragrafi 303, i publikuar më 07.09.2023, dhe i disponueshëm në anglisht në linkun vijues: [1680ac76ab](#)

## 5.4.2

### LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje<sup>36</sup> është një instrument ligjor thelbësor që thekson angazhimin e shtetit për trajtimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Ky ligj, për herë të parë, fut një përkufizim të qartë të dhunës me bazë gjinore, në përputhje me Konventën e Stambollit, dhe përcakton parimet e parandalimit, mbrojtjes, sanksionimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Ligji mbulon një gamë të gjerë formash të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, por edhe format bashkëkohore si ngacmimi seksual online. Në këtë mënyrë, hapësira dixhitale njihet si një kontekst potencial për dhunën ndaj grave, duke hapur mundësi për mbrojtje edhe përmes mekanizmave të përshtatur ndaj teknologjive të reja. Megjithatë ligji parashikon vëmendje të veçantë për kategoritë e cënueshme të grave – si gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale, gratë migrante dhe të tjera – gazetaret nuk përmenden shprehimisht si një kategori e veçantë, pavarësisht rreziqeve specifike me të cilat ato përballen në hapësirën publike dhe online. Kjo tregon nevojën për avancimin e mëtejshëm të kornizës normative, e cila do t'i njohë këto profesioniste si një grup të ekspozuar ndaj formave specifike të dhunës.

Megjithatë, sipas tekstit të ligjit, të gjitha shërbimet e parashikuara – si kujdesi, mbështetja psikologjike dhe ligjore, mbrojtja urgjente dhe rehabilitimi afatgjatë – janë në dispozicion të të gjitha grave që janë përballur me dhunë me bazë gjinore. Kjo do të thotë se gazetaret, edhe pse nuk janë të veçuara posaçërisht, mund të kenë qasje në të gjitha mekanizmat e mbrojtjes dhe mbështetjes kur ekspozohen ndaj dhunës që lidhet me gjininë e tyre.

## 5.4.3

### LIGJI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Ligji për ndihmë juridike falas<sup>37</sup> është një mekanizëm thelbësor që siguron **qasje në drejtësi** për qytetarët që gjenden në një pozitë të cënueshme ose të pafavorshme. Ligji parashikon dy lloje të ndihmës juridike falas:

- **Ndihma juridike parësore:** Kjo përfshin këshilla themelore ligjore dhe informacione.
- **Ndihma juridike dytësore:** Kjo nënkupton përfaqësimin në gjykatë, hartimin e parashtresave dhe mbështetje tjetër më komplekse ligjore.

36 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/1a28a922f364401e94935d4d694b9d75.pdf>

37 Ligji për Ndhmë Juridike Falas, 16.05.2019, <https://www.pravda.gov.mk/upload/Documents/Zakon%20za%20besplatna%20pravna%20pomos.pdf>

Të drejtën për ndihmë juridike falas e kanë personat me të ardhura të ulëta dhe me mjete të kufizuara pasurore, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Për të marrë këtë ndihmë, ata duhet të paraqesin një kërkesë dhe të bashkëngjisin dokumentacionin që vërteton gjendjen e tyre financiare. Përveç kësaj, ndihma juridike falas mund të ofrohet edhe nga ofrues të autorizuar, siç janë shoqatat e qytetarëve që plotësojnë kriteret e caktuara.

Një dispozitë e rëndësishme në ligj është se **viktimat e dhunës në familje janë grupi i vetëm i kërkuesve që janë të përjashtuar nga detyrimi për të provuar gjendjen e tyre financiare** për të marrë ndihmë juridike falas. Ky është një hap pozitiv drejt mbrojtjes së këtyre personave, por tregon kufizimet e ligjit në lidhje me format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Viktimat e dhunës seksuale, ngacmimit seksual, dhunës digjitale ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore që nuk janë familjare, duhet ende të provojnë gjendjen e tyre materiale, gjë që paraqet një barrierë në qasjen në drejtësi. Kjo hap hapësirë për përmirësimin e ligjit në drejtim të trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes së të gjitha viktimave të dhunës me bazë gjinore, pavarësisht nga forma në të cilën ajo manifestohet.

## — 5.5 KORNIZA LIGJORE NË SEKTORIN E PUNËS

Korniza ligjore që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazohet kryesisht në **Ligjin për Marrëdhëniet e Punës**, i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet themelore të punëtorëve dhe punëdhënësve. Ligji ndalon **diskriminimin në punësim dhe gjatë marrëdhënies së punës** në bazë të gjinisë, seksit, orientimit seksual, moshës, përkatësisë etnike dhe bazave të tjera, dhe garanton **pagë të barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë**. Gjithashtu, përmban dispozita për mbrojtjen nga ngacmimi dhe mobingu, por pavarësisht kësaj, ka ende sfida në zbatimin dhe sanksionimin e këtyre rasteve.

Ligji lejon lidhjen e kontratave të punës me kohë të caktuar deri në maksimum pesë vjet, praktikë që shpesh zbatohet te gazetarët dhe punonjësit e medias, ku një pjesë e madhe e tyre punojnë nën kontrata të tilla. Kjo ndikon drejtpërdrejt në **sigurinë e tyre ekonomike, stabilitetin dhe mundësinë për të planifikuar të ardhmen profesionale**.

**Ligji për Mbrojtjen nga Ngacmimi në Vendin e Punës** forcon më tej mbrojtjen ligjore të punëtorëve, duke parashikuar procedura për ankesa të brendshme dhe të jashtme, si dhe sanksione për punëdhënësit që nuk marrin masat e duhura. Megjithatë, efektiviteti i këtij ligji varet nga niveli i informimit të punëtorëve dhe vullneti i institucioneve për të vepruar sipas ankesave.

Lidhur me negociimet kolektive, servisi publik (RTM) ka kontratën e tij kolektive që rregullon kushtet e punës, pagat dhe të drejtat e punonjësve të medias në atë sistem. Megjithatë, një

kontratë kolektive në nivelin e sektorit privat të medias ende nuk ekziston, gjë që i lë gazetarët dhe punonjësit e medias në mediat private me më pak mbrojtje ligjore dhe sindikale, veçanërisht në lidhje me oraret e punës, pagat dhe kushtet e punës.

## — 5.6 ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE

Pavarësisht ekzistencës së këtyre ligjeve, **efikasiteti i tyre në mbrojtjen e gazetareve është i kufizuar**. Një nga problemet kyçe është **hetimi**. Në praktikë, shumë raste të kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve nuk hetohen në mënyrë efikase, dhe sulmuesit rrallë dalin para drejtësisë. Kjo krijon një **kulturë mosndëshkimi** që inkurajon sulmet e mëtejshme.

Për më tepër, problem janë edhe **sanksionet joadekuate dhe politika e lehtë e dënimit**: edhe kur shqiptohen dënime, ato shpesh janë të lehta dhe nuk përkojnë me seriozitetin e rasteve dhe veprave penale. Mbrojtja civile përmes Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili gjithashtu parashikon ngacmimin dhe ngacmimin seksual dhe vlen për mediat, por deri më tani nuk ka informacion që ndonjë gazetarë ta ketë shfrytëzuar këtë mekanizëm ligjor për mbrojtje nga ngacmimi seksual që ka përjetuar në vendin e punës ose jashtë tij, përfshirë mediat sociale, kur ka qenë i lidhur me profesionin e saj<sup>38</sup>. Ligjet për mbrojtjen nga shpifja dhe fyerja nuk aplikohen gjithmonë në mënyrë efikase në hapësirën digjitale, ku ngacmimi online dhe gjuha e urrejtjes janë gjerësisht të përhapura. Ekziston gjithashtu një **mungesë e qasjes së ndjeshme ndaj gjinisë në kornizën ligjore**, veçanërisht ajo që lidhet me mediat, duke pasur parasysh se ligjet nuk marrin parasysh sfidat specifike me të cilat përballen gazetarët<sup>39</sup>.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka ndërmarrë disa iniciativa për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve. Ministria e Punëve të Brendshme ka krijuar njësi speciale për hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve, ndërsa Prokuroria Publike ka emëruar prokurorë përgjegjës për rastet që përfshijnë punonjës të medias<sup>40</sup>. Megjithatë, këto iniciativa shpesh përballen me probleme si:

Mungesa e burimeve dhe trajnimit: Punonjësit e policisë dhe gjyqësorit shpesh nuk kanë burime dhe trajnim të mjaftueshëm për të trajtuar në mënyrë efikase rastet komplekse të dhunës ndaj gazetarëve, veçanërisht në hapësirën digjitale.

Procedura të ngadalta dhe joefikase: Hetimet shpesh zgjasin shumë, dhe procedurat gjyqësore janë të ngadalta, gjë që ul besimin e gazetarëve te institucionet.

38 Maqedonia e Veriut: Indikatorët e Shkallës së Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/09/MK-MK-2024.pdf>

39 Maqedonia e Veriut: Indikatorët e Shkallës së Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2024/09/MK-MK-2024.pdf>

40 Përmirësimi i Sigurisë së Gazetarëve Përmes Ndryshimeve në Kodin Penal – Një Analizë e Standardeve Ndërkombëtare dhe Rregullativave Vendase, <https://shorturl.at/s76w0>

Mungesa e koordinimit: Ekziston një mungesë koordinimi midis institucioneve të ndryshme, gjë që e vështirëson trajtimin efikas të rasteve të dhunës.

Organet rregullatore, siç është Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAAV), luajnë një rol në promovimin e lirisë së medias dhe standardeve profesionale. Megjithatë, mandati i tyre është kryesisht i fokusuar në rregullimin e transmetimit dhe ato kanë kompetenca të kufizuara për të trajtuar ngacmimet online dhe forma të tjera të dhunës ndaj gazetarëve. Organizatat e shoqërisë civile, siç janë Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGMP), janë thelbësore në avokimin për lirinë e medias dhe ofrimin e mbështetjes për gazetarët. Ato ofrojnë ndihmë ligjore dhe psikologjike, monitorojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe rrisin ndërgjegjësimin për sfidat me të cilat përballen gratë në media. Megjithatë, mungesa e sistemeve të mjaftueshme të mbështetjes për gazetaret që përballen me dhunë dhe kërcënime është një sfidë e rëndësishme. Edhe pse SHGM dhe SPGMP ofrojnë mbështetje përmes ndihmës ligjore dhe këshillimit psikologjik, këto shërbime shpesh janë të kufizuara në shtrirje dhe disponueshmëri, duke marrë parasysh se këto shoqata nuk mbështeten financiarisht nga shteti. Përveç ndihmës financiare të nevojshme për mbështetje ligjore dhe psikologjike, është e nevojshme të sigurohen edhe fonde për ndihmë urgjente që do të përfshinin mbështetje financiare për gazetaret që duhet të zhvendosen për shkak të kërcënimeve serioze.

# VI

## Analizë e të Dhënave – Siguria e Gazetareve 2021–2024

Sulmet dhe kërcënimet fizike janë më të dukshmet dhe të drejtpërdrejta, por jo më pak shqetësuese janë kërcënimet online, të cilat shpesh lënë pasojë psikologjike afatgjata. Gazetaret që raportojnë për tema të ndjeshme si korrupsioni, të drejtat e njeriut ose çështjet gjinore janë më të ekspozuara ndaj sulmeve.

### – 6.1 PASQYRË E SITUATËS

Në Maqedoninë e Veriut, **siguria e gazetareve** pasqyron sfida globale, por vjen edhe me karakteristika specifike që vështirësojnë punën e tyre. Gazetaret shpesh janë shënjestër e **kërcënimeve fizike dhe verbale**, si dhe **sulmeve online** që shpesh përfshijnë fyerje dhe nënçmime me bazë gjinore. Këto kërcënime janë veçanërisht të theksuara kur ato mbulojnë tema të ndjeshme si **korrupsioni politik, krimi i organizuar apo barazia gjinore**. Sulmet nuk kufizohen vetëm në punën e tyre profesionale; ato shpesh prekin edhe **privatësinë** e tyre, me kërcënime për sigurinë e tyre dhe të familjeve. Kjo rrit barrën psikologjike me të cilën ato përballen, duke çuar në **vetëcensurë** ose tërheqje nga hapësira publike. Normat shoqërore dhe barrierat kulturore në Maqedoninë e Veriut e komplikojnë më tej situatën. Gazetaret përballen me **paragjykime edhe brenda redaksive**, ku mund të marrin më pak mbështetje dhe respekt nga kolegët meshkuj. Situata përkeqësohet nga **presionet politike dhe kërcënimet** nga individë ose grupe të fuqishme që synojnë të heshtin debatin kritik. Edhe pse ka përpjekje për mbrojtje institucionale dhe mbështetje për gazetaret, si përmes ndryshimeve ligjore ose programeve të mbrojtjes, këto masa shpesh perceptohen si

**jo mjaftueshëm efektive**<sup>41</sup>. Sistemi i drejtësisë jo gjithmonë ofron mbrojtje të shpejtë dhe të përshtatshme, apo sanksione efektive për sulmuesit. Kjo e çënon më tej ndjenjën e sigurisë të gazetaret. Megjithatë, shoqatat profesionale, organizatat e gazetarëve dhe partnerët ndërkombëtarë luajnë një rol thelbësor në rritjen e ndërgjegjësimit publik për këtë problem dhe në forcimin e kapaciteteve për të mbrojtur gazetaret. Për ndryshime reale, nevojitet një angazhim i vazhdueshëm dhe një qasje sistematike. Liria e medias dhe siguria e gazetarëve janë shtylla kryesore e çdo shoqërie demokratike dhe një komponent i rëndësishëm për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut. Ato sigurojnë që publiku të ketë qasje në informacione të besueshme dhe të pavarura, gjë që është thelbësore për transparencën dhe llogaridhënien e strukturave qeveritare dhe shoqërore. Siguria e gazetarëve është jetike për realizimin e lirisë së medias, pasi krijon kushtet që gazetaret të kryejnë detyrat e tyre pa frikë nga represioni, dhuna apo frikësimi.

Të dhënat e reja nga hulumtimet<sup>42</sup>, Gjetjet e reja të hulumtimit në Maqedoninë e Veriut zbulojnë se ndërsa diferenca gjinore në paga pothuajse nuk ekziston në sektorin mediatik, ka një pasiguri ekonomike të përgjithshme. Kjo është veçanërisht e dukshme pasi një pjesë e madhe e punonjësve të medias nuk arrijnë pagën mesatare neto: 57% e gazetarëve meshkuj dhe 42% e gazetarëve nuk e arrijnë pagën mesatare neto. Për punonjësit e medias, situata është edhe më e pafavorshme: 80% e meshkujve dhe 73% e grave janë nën këtë kufi. Në përgjithësi, pothuajse gjysma e gazetarëve dhe 77% e punonjësve të medias fitojnë nën pagën mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Lidhur me kompensimin për orët jashtë orarit dhe punën gjatë festave: 38% e gazetarëve dhe 36% e punonjësve të medias nuk marrin kompensim për orët jashtë orarit (vazhdimisht ose shpesh). Dhe kur bëhet fjalë për punën gjatë festave, 46% e të gjithë të anketuarve deklaruan se puna e tyre gjatë festave rrallë ose kurrë nuk u është paguar. Vlen të theksohet se gazetaret dhe punonjësit e medias në servis publik (TVM) janë në një pozitë më të mirë ekonomike se kolegët e tyre në sektorin privat, pasi kanë paga më të larta. Sa i përket avancimit në karrierë, të dhënat tregojnë një diferencë gjinore në pozicionet redaktoriale. Edhe pse gazetaret përbëjnë 56% të numrit total të gazetarëve në media, gratë janë 6% më pak të përfaqësuara se burrat në pozicionet redaktoriale. Një hartëzim i kryer në vitin 2023 zbulon se nga 188 redaktorë në sferën mediatike, vetëm 89 janë gra, pra 47.3% e totalit<sup>43</sup>. Kur bëhet fjalë për radion dhe televizionin, të dhënat mbledhen nga rregullatori i medias. Sipas informacioneve të vitit 2023, nga gjithsej 155 redaktorë në sektorin e transmetimit, 77 janë gra – pothuajse gjysma e numrit të përgjithshëm<sup>44</sup>.

41 Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve përmes ndryshimeve në Kodin Penal: Analizë e standardeve ndërkombëtare dhe rregullativave vendase, <https://shorturl.at/s76w0>

42 Tërpevska, Snezhana, „Работните услови во медиумскиот сектор: „Професионален статус и работнички права на новинарите и медиумските работници“, SPGPM, Institutit RESIS, Shkup, 2024.

43 Hartëzimi i Popullsisë së Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias, Institutit RESIS dhe SPGPM, Shkup 2024

44 Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, „Struktura e Punonjësve në Industrinë e Medias Audio dhe Audiovizuale në vitin 2022“, gusht, 2023.

## — 6.2

### NORMAT PATRIARKALE QË NDIKOJNË NË TRAJTIMIN E GRAVE NË MEDIA

Vlerat patriarkale, të cilat janë ende të pranishme në shumë struktura shoqërore, luajnë një rol kyç në formësimin e trajtimit të grave në media. Normat dhe pritshmëritë tradicionale i vendosin gratë në një pozicion të nënshtruar, duke u imponuar kufizime në autonominë dhe ndikimin e tyre në hapësirën publike. Gratë në media përballen me sfida si **dukshmëria e reduktuar, përfaqësimi i pamjaftueshëm në pozitë drejtuese, dhe mungesa e mundësive për vendimmarrje**. Këto norma, që theksojnë rolet tradicionale gjinore, e vështirësojnë më tej luftën për barazinë gjinore, duke nxitur një kulturë të nënçmimit dhe injorimit të punës dhe ndikimit të tyre. Në industrinë mediatike, vlerat dhe normat patriarkale shpesh reflektohen edhe në politikën e brendshme të redaktimit dhe raportimit. Gazetarët që sfidojnë këto norma duke mbuluar tema të ndjeshme ose kontroverse shpesh ekspozohen ndaj reagimeve armiqësore dhe seksiste nga publiku. Këto sulme, të nxitura nga paragjykime të thella dhe rezistencë ndaj ndryshimeve, synojnë t'i heshtin gratë dhe të ruajnë dominimin e zërave mashkullorë në hapësirën publike. Një pjesë e gazetarëve deklarojnë se në këtë mjedis shpesh janë të ekspozuara ndaj komenteve të karakterit seksist, presioneve ose fyerjeve, thjesht për faktin se janë gra<sup>45</sup>. "Në rastin e publikimit të ndonjë historie hulumtuese apo teksti, fenomeni më i shpeshtë i kërcënimeve dhe frikësimit ndaj gazetarëve ndodh në rrjetet sociale nga burra të panjohur. Komentet janë nënçmuese, seksiste dhe shumë shoviniste, thjesht pse autori i atij teksti apo historie është një grua"<sup>46</sup>.

## — 6.3

### TË DHËNA STATISTIKORE

Viti	Numri i sulmeve	Gjinia	Lloji i sulmit
2024	2	Grua	Ndjekje dhe inçizim i paautorizuar, kërcënime online
2024	2	Burrë	Djegje automjeti/shkatërrim prone, sulm fizik
2023	3	Burrë	Kërcënim i qartë online, sulm fizik dhe verbal
2023	3	Grua	Sulm fizik, kërcënim i qartë online
2022	7	Burrë	Sulm fizik me sëpatë, sulm verbal, kërcënim me vdekje online, ndalim i paligjshëm, sulm fizik
2022	1	Grua	Sulm verbal
2021	3	Grua	Kërcënim, sulm verbal
2021	2	Burrë	Kërcënime me vdekje ndaj grupit, sulm ndaj ekipit televiziv

Sipas raporteve të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe organizatave të tjera, raste të shumta të frikësimit dhe kërcënimeve rrallëherë përfundojnë me pasoja të dhura

45 Grupet e fokusit me gazetarë dhe gazetare, të realizuara nga Milan Spirovski më 26.12.2024 dhe më 24.01.2025.

46 Deklaratë e një redaktoreje-gazetareje nga një media e shkruar dhe online, e dhënë për qëllimet e këtij raporti, si pjesëmarrëse në grupin e fokusit më 26.12.2024.

ligjore. Kjo rezulton në një kulturë mosndëshkimi dhe në një ndjenjë pasigurie te gazetaret e prekura. Më së shpeshti, gazetaret ekspozohen ndaj kërcënimeve kur raportojnë për afera politike, korrupsion apo tema lidhur me të drejtat e njeriut. Platformat online dhe mediat sociale përdoren për sulme agresive dhe përndjekje dixhitale, gjë që e bën dhunën më të vështirë për t'u gjurmuar dhe ndëshkuar<sup>47</sup>. Shpesh, komentet dhe kërcënimet që marrin gazetaret kanë një **përmbajtje thellësisht seksiste dhe nënçmuese**, duke përfshirë tentativa për t'i heshtur ato përmes diskreditimit bazuar në gjininë e tyre. Megjithëse ka përpjekje të shtuara për të adresuar këtë problem, si përmes iniciativave për **forcimin e sigurisë së punonjësve të medias** dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, sfidat mbeten. Sistemi institucional përballet me **dobësi në identifikimin dhe sanksionimin e autorëve**, si dhe me pengesa në zbatimin e masave mbrojtëse. Gazetaret shpesh kanë **qasje të kufizuara në ndihmë ligjore dhe mbështetje institucionale**, gjë që rrit më tej cenueshmërinë e tyre. Kjo situatë kërkon që autoritetet kompetente dhe aktorët shoqërorë të ndërmarrin përpjekje të shtuara për të krijuar një **mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë profesionistët e medias**<sup>48</sup>.

Gjatë periudhës 2021-2024, në Maqedoninë e Veriut janë regjistruar të paktën 23 raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias. Këto sulme përfshijnë kërcënime fizike dhe verbale, shkatërrim prone, ndjekje dhe incizim të paautorizuar, dhe shpesh shoqërohen me pasoja serioze psikologjike. Një pjesë e këtyre rasteve kanë marrë një zgjidhje ligjore, ndërsa të tjerat mbeten të pahetuara plotësisht ose të paprocesuara sa duhet. Në vitin 2021 u shënua numri më i madh i incidenteve – plot 10 raste, shumica e të cilave lidheshin me proceset politike dhe zgjedhore. Gazetaret ishin veçanërisht të cenueshme ndaj kërcënimeve dhe fyerjeve verbale, shpesh nga përfaqësues të institucioneve apo nga publiku. Kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2023, kur tre gazetarë u shënjestruan me kërcënime online ose sulme fizike. Në vitet 2022 dhe 2024, theksi u zhvendos gjithashtu te sulmet fizike dhe shkatërrimi i pronës, kryesisht ndaj gazetarëve që raportojnë nga terreni, jashtë Shkupit. Këto lloj sulmesh, megjithëse raportohen më rrallë, janë edhe më të rrezikshmet – duke përfshirë përdorimin e armëve ose djegien e automjeteve. Gazetaret janë dukshëm më të ekspozuara ndaj dhunës online, ndjekjes së paautorizuar dhe sulmeve verbale, veçanërisht kur bëhet fjalë për angazhimin dhe praninë e tyre publike në rrjetet sociale. Arsyet për këtë janë të shumëfishta – nga mbrojtja e ulët institucionale, deri te stereotipat gjinorë që i trajtojnë gazetaret si "objektiv të përshtatshëm" për dënim publik dhe keqtrajtim. Gjithashtu, ekziston një shpërndarje e dukshme gjeografike – shumica e incidenteve ndodhin në Shkup, por intensiteti dhe ashpërsia e dhunës shpesh është më e theksuar në brendësi të vendit

47 Deklaratë e një gazetares-redaktoreje në një media të shkruar dhe online, pjesëmarrëse në grupin fokus të organizuar për qëllimet e këtij raporti më 24.01.2025.

48 <https://ssnm.org.mk/komentari/%D0%B0%D0%BB%D0%B0%D1%82%D0%BA%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D0%BD%D0%BB%D0%B0%D1%98%D0%BD-%D0%B2%D0%BE%D0%B7%D0%BD%D0%B5%D0%BC%D0%B8%D1%80-%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80>

(Gostivar, Kërçovë, Rosoman, Shtip), ku gazetarët janë më të izoluar dhe kanë më pak qasje në mekanizmat mbrojtës.

Gazetarët më shpesh ekspozohen ndaj kërcënimeve online dhe gjuhës së urrejtjes (Facebook, Twitter), fyerjeve verbale të drejtpërdrejta ose gjatë ngjarjeve publike, si dhe ndjekjes dhe incizimit të paautorizuar (përfshirë shpërndarjen e materialeve video). Këto sulme shpesh synojnë t'i diskreditojnë, turpërojnë ose frikësojnë ato që të ndërpresin aktivitetin e tyre profesional, sipas raporteve të shumta ndërkombëtare, (si ato të UNESCO-së<sup>49</sup> dhe IFJ<sup>50</sup>), dhuna e bazuar në gjini ndaj gazetarëve është një prirje globale, por ajo është veçanërisht e theksuar në shoqëritë në tranzicion ku mediat janë nën presion të shtuar politik.

## — 6.4 RASTET E SULMEVE NDAJ GAZETAREVE TË REGJISTRUARA NGA SJN NË MAQEDONINË E VERIUT

Vitet e fundit, gazetarët në Maqedoninë e Veriut po përballen me një numër në rritje të rasteve të dhunës dhe kërcënimeve, duke reflektuar kështu krizën më të gjerë të lirive të medias dhe sigurisë në vend. Sipas regjistrimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias, të cilin Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) e ka përditësuar që nga viti 2014, nga viti 2021 deri më tani janë regjistruar **23 raste të shkeljeve të rënda të të drejtave të gazetarëve** të cilat e kanë raportuar incidentin pranë SHGM-së<sup>51</sup>. Këto incidente manifestohen në forma të ndryshme, duke përfshirë **sulme fizike dhe verbale, ngacmime online dhe diskreditim me bazë gjinore**, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të raportuar lirshëm.

Trendi i vërejtur në vitin 2024 është se me ndryshimin e gazetarisë, po ndryshojnë edhe format e dhunës. Sot, sulmet ndaj gazetarëve nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht vetëm dhunë fizike, pasi kërcënimet verbale dhe ngacmimet po regjistrohen gjithnjë e më shpesh. Në vitin 2024, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) regjistroi gjithsej **4 raste të sulmeve dhe kërcënimeve të rënda** ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, çka përbën një ulje krahasuar me vitet e mëparshme. Të gjitha këto raste u raportuan në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Midis tyre, dy incidente dallohen si më karakteristike: sulmet ndaj gazetarëve **Lepa Xhundeve** dhe **Miroslava Simonovska**.

49 UNESCO's Global Survey on Online Violence against Women Journalists, [https://www.unesco.org/en/articles/unescos-global-survey-online-violence-against-women-journalists?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.unesco.org/en/articles/unescos-global-survey-online-violence-against-women-journalists?utm_source=chatgpt.com)

50 International Federation of Journalists (IFJ) Survey, [https://www.ifj.org/media-centre/reports/detail/ifj-survey-one-in-two-women-journalists-suffer-gender-based-violence-at-work/category/press-releases?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.ifj.org/media-centre/reports/detail/ifj-survey-one-in-two-women-journalists-suffer-gender-based-violence-at-work/category/press-releases?utm_source=chatgpt.com)

51 Regjistri i rasteve të shkeljeve të të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias i SHGM-së, <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

## RASTI LEPA XHUNDEVA

Në vitin 2024, SHGM-ja regjistroi dy incidente serioze të shkeljes së të drejtave të gazetareve. Rasti i parë ka të bëjë me gazetaren **Lepa Xhundeva** nga TV24, e cila u bë objektivi i komenteve kërcënuese për jetën në rrjetin social Facebook nga palë të treta. Këto komente lidheshin me intervistën e saj me deputetin grek Syrigos. Një pjesë e kësaj interviste, e nxjerrë nga konteksti, u publikua në profilin e tij në Facebook nga Bogdan Ilievski, një prezantues emisioni televiziv i mbrëmjes, duke nxitur kështu gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime që mund të çojnë në dhunë.

Disa media online si Off.net.mk vazhduan fushatën shpifëse kundër Xhundeva-s, duke përdorur imazhin e saj nga rrjetet sociale, gjë që nxiti më tej fyerje personale, thirrje për nënçmim, komente seksiste, si dhe kërcënime të qarta për jetën e gazetares nga palë të treta që komentnin këto postime. Për këtë rast me gazetaren Lepa Xhundeva, SHGM pati një reagim publik<sup>52</sup> dhe ofroi ndihmë juridike falas, si dhe nga ana e SHGM-së u njoftua edhe prokuroria. Rasti është ende në procedurë prokuroriale.

## RASTI MIROSLAVA SIMONOVSKA

Incidenti i dytë përfshin gazetaren **Miroslava Simonovska** nga "Sloboden Pecat", e cila në vitin 2024 ishte viktimë e ndjekjes, incizimit dhe shpërndarjes së paautorizuar të materialit video. Sipas informacioneve, Simonovska ishte ndjekur dhe incizuar fshehurazi, dhe një video ku ajo gjoja merrte një dokument, ishte shpërndarë në media pa pëlqimin e saj. Sipas të dhënave që ka SHGM, një shkelje kaq e rëndë e të drejtave nuk u ka ndodhur kurrë kolegëve meshkuj gazetarë. Këto raste theksojnë shqetësimin e vazhdueshëm për sigurinë e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht për gazetarët të cilat përballen me forma specifike të frikësimit dhe ngacmimit.

Është e rëndësishme të përmendet rasti i gazetares **Rita Behadini** në vitin 2023, ku Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) kërkoi reagim të menjëhershëm për kërcënimet e qarta drejtuar gazetares Rita Behadini në postimin e saj lidhur me qëndrimin publik të hoxhës nga Saraj në rrjetin social Facebook. Gazetarja Behadini iu drejtua SHGM-së me një ankesë se ishte objektivi i kërcënimeve nga persona me profile në rrjetin social Facebook, por veçanërisht spikat njëri që përmbante **një kërcënim të qartë**. Postimi nga një profil i caktuar i quajtur Fisnik Hoxha përmban një kërcënim të qartë për dhunë seksuale ndaj familjes së gazetares Behadini dhe një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj saj për dhunë fizike<sup>53</sup>. Me një postim të tillë, çënohet siguria e gazetares, siguria e familjes së saj, dhe potencialisht edhe siguria e kolegëve

52 SHGM, Reagim Publik: Ngacmimet online dhe kërcënimet ndaj Lepa Xhundevas dhe gazetareve të tjera janë të papranueshme (06.06.2024), <https://znm.org.mk/%D0%BE%D0%BD%D0%BB%D0%B0%D1%98%D0%BD-%D0%BC%D0%B0%D0%BB%D1%82%D1%80%D0%B5%D1%82%D0%B8%D1%80%D0%B0%D1%9A%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BA%D0%BE%D0%BD/>

53 Teksti i plotë i postimit kërcënues është si vijon: "Hajde fshije postimin që shkrove kundër hoxhës, familjen do ta ç\*\*\*\*. Nesër do të vij para Alsatit, veshin do ta pres me thikë."

të tjerë nga ky medium. Ky kërcënim i qartë për jetën e gazetares Behadini është denoncuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), pranë Sektorit për Krim Kibernetik dhe Forenzikë Digjitale. Njëkohësisht, SHGM do të insistojë në një hetim të shpejtë dhe efikas, në interes të gjetjes dhe sanksionimit të autorit ose autorëve të këtij kërcënimi. Rasti është në procedurë gjyqësore dhe SHGM po e monitoron aktivisht këtë rast deri në zgjidhjen e tij përfundimtare.

# VII Përvoja dhe Perceptime mbi Sigurinë e Gazetareve

Ky kapitull përmban informacione dhe njohuri cilësore të marra përmes intervistave dhe grupeve fokus me gazetarë, eksperte dhe redaktore, duke theksuar përvojat e tyre me format e ndryshme të ngacmimit dhe dhunës me të cilat ndeshen në aktivitetet e tyre profesionale. Analiza përfshin dëshmi të drejtpërdrejta nga gra-gazetarë që lidhen me format e ndryshme të dhunës dhe frikësimit, si dhe mungesën e mekanizmave të mjaftueshëm mbështetës institucionalë, si dhe një hulumtim të arsyeve pse ato shpesh zgjedhin të mos raportojnë incidentet e përjetuara. Të dhënat cilësore në këtë pjesë mbështeten më tej edhe nga tendencat e konstatuara në analiza të tjera, fokusi i të cilave janë aspektet e sigurisë së gazetareve në Maqedoninë e Veriut.

Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, gazetaret përballen me sfida specifike që janë të rrënjësura në rrethanat socio-politike, normat gjinore dhe kulturën mediatike të vendit. Maqedonia e Veriut përballlet me tensionet e vazhdueshme midis nevojës për liri të medias dhe presionit politik e ekonomik që shpesh reflektohet mbi gazetarët. Në këtë situatë, gazetaret janë veçanërisht të cenueshme, pasi shpesh duhet të përballen me një barrë të dyfishtë – të dëshmojnë kompetencën e tyre profesionale në një industri të dominuar nga burrat dhe të përballen me pritshmëritë dhe paragjykimet shoqërore<sup>54</sup>. Një nga problemet kryesore në Maqedoninë e Veriut është mbrojtja dhe mbështetja e pamjaftueshme nga institucionet. Megjithatë ekzistojnë ligje që garantojnë lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve, zbatimi i tyre shpesh është joefikas<sup>55</sup>.

Institucionet nuk reagojnë shpejt dhe në mënyrë adekuate ndaj raporteve për dhunë dhe kërcënime, gjë që lë hapësirë për mosndëshkueshmëri dhe viktimizim shtesë të viktimave. Kjo vlen veçanërisht për rastet e dhunës online, ku ligjet janë ende të pazhvilluara sa duhet për t'u përballur me kompleksitetin e kërcënimeve digjitale. Presioni politik dhe ndikimi mbi mediat e ashpësojnë më tej situatën. Gazetarët që raportojnë në mënyrë kritike për aktivitetet qeveritare ose për partitë politike shpesh shënjestrohen me kërcënime, fushata diskredituese

54 Deklaratë e një gazetareje pjesëmarrëse në grupin e fokusit, të organizuar për qëllimet e këtij raporti më 26.12.2024.

55 Gratë fuqi punëtore, burrat në pozita vendimmarrëse – ky është imazhi më i shpeshtë në media., <https://shorturl.at/ECzO4>

dhe sulme verbale. Aktorët politikë, përmes platformave të tyre ose mbështetësve, përdorin taktika të ndryshme për të heshtur zërat kritikë, dhe gratë janë zakonisht më të cenueshme për shkak të paragjytimeve gjinore që i paraqesin ato si "më pak kompetente" ose "më emocionale".

Një tjetër pengesë e madhe është mospranimi kulturor dhe shoqëror i grave në hapësirën publike. Shoqëria maqedonase, megjithëse ka arritur përparim të konsiderueshëm në lidhje me të drejtat e grave, ende bart elemente të patriarkalizmit që ndikojnë në trajtimin e gazetareve. Këto paragjytime i bëjnë gratë më të ekspozuara ndaj nënçmimit, talljes dhe ngacmimit të seksualizuar. Siguria e gazetareve kërkon angazhim serioz dhe një qasje shumëdimensionale për zgjidhjen e saj. Kjo përfshin reforma ligjore për mbrojtje më efikase, edukimin e publikut për rëndësinë e barazisë gjinore, përmirësimin e mekanizmave institucionalë për trajtimin e kërcënimeve dhe krijimin e një rrjeti mbështetës për gazetaret. Ruajtja e sigurisë së tyre nuk është vetëm çështje drejtësie, por edhe një kusht thelbësor për pluralizmin dhe stabilitetin demokratik në shoqëri<sup>56</sup>.

Dhuna ndaj gazetareve përbën një kërcënim serioz, jo vetëm për mirëqenien e tyre personale dhe profesionale, por edhe për shoqërinë në tërësi. Gazetaret, të cilat përballen me forma të ndryshme sulmesh, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe digjitale, janë të detyruara të funksionojnë në një mjedis frike dhe pasigurie të vazhdueshme. Përvoja të tilla lënë gjurmë të thella në shëndetin e tyre mendor dhe kufizojnë ndikimin e tyre profesional, gjë që ka pasoja më të gjera mbi lirinë e medias dhe proceset demokratike në vend.

## LLOJE TË DHUNËS

Sfidat kryesore me të cilat përballen gazetaret përfshijnë **kërcënimet e vazhdueshme të dhunës fizike, verbale dhe online**. Në Maqedoninë e Veriut, këto kërcënime përforcohen nga normat shoqërore dhe presionet politike, ku gratë që raportojnë për tema të ndjeshme (korrupsioni, politika, të drejtat e njeriut) shpesh bëhen shënjestër sulmesh. Abuzimi online është rritur ndjeshëm, me komente të dhunshme dhe kërcënime kibernetike që rrezikojnë sigurinë personale dhe stabilitetin profesional të gazetareve<sup>57</sup>. Në këtë klimë, viktimat detyrohen të vetëcensurohen dhe të heqin dorë nga temat hulumtuese, gjë që dobëson më tej pluralizmin mediatik dhe ndikimin e diskursit publik. Megjithatë, është arritur edhe njëfarë progresi. Nismat legjislative që parashikojnë mbrojtjen e gazetarëve, angazhimet e sektorit civil dhe mbështetja nga organizatat ndërkombëtare janë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë<sup>58</sup>. Platformat e solidaritetit dhe trajnimit ofrojnë mbështetje të shtuar për

56 Liria e medias në Maqedoninë e Veriut: Progres mbi këmbë qelqi Raport nga Misioni i Vlerësimit të Gjendjes së Lirisë së Medias <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/11/%D0%9C%D0%9A-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web-final.pdf>

57 Deklaratë e një gazetareje pjesëmarrëse në grupin e fokusit, organizuar për qëllimet e këtij raporti më 26.12.2024.

58 Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve përmes ndryshimeve në Kodin Penal – Analiza e standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve vendase, <https://www.kas.de/documents/281657/281706/Belegexemplar+2020+Improving+the+safety+of+journalists+MK+web.pdf/1866ee0b-d92e-756e-2d34-880e19e352e4?version=1.0&t=1608021648138>

gazetaret, megjithëse nevoja për reforma të mëtejshme dhe zbatim të shtuar të ligjeve ekzistuese mbetet urgjente.

## DHUNA DHE SULMET FIZIKE

Dhuna ndaj gazetares paraqet një problem serioz që kërcënon integritetin e profesionit të gazetarisë dhe lirinë e medias. Gazetaret, të cilat shpesh janë shënjestër e akteve të dhunshme, janë të ekspozuara ndaj një rreziku të konsiderueshëm nga sulmet fizike, veçanërisht në situatat kur raportojnë për tema të ndjeshme, si korrupsioni ose çështjet gjinore. Dhuna fizike ndaj gazetares ka pasoja të shumëfishta dhe afatgjata. Përveç lëndimeve të menjëhershme fizike, sulmet sjellin edhe trauma psikologjike, të cilat mund të çojnë në ankth, depresion dhe probleme të tjera psiko-sociale ose shëndetësore. Gazetaret shpesh përballen me kërcënime për dhunë fizike, të cilat shprehen si formë frikësimi ose si mesazh që ato nuk duhet të vazhdojnë punën e tyre hulumtuese. Këto kërcënime kryhen nga përfaqësues qeveritarë, interesa biznesi, ose grupe të tjera të fuqishme që ndihen të kërcënuara nga hetimet gazetareske.

Në shumë raste, sulmet ndaj gazetares nuk kufizohen vetëm në dhunë fizike, por ato mund të jenë pjesë e një konteksti më të gjerë të pabarazisë gjinore dhe diskriminimit. Si rezultat i dhunës fizike, gazetaret përballen me pengesa serioze në punën e tyre. Shumë prej tyre mendojnë të ndërpresin karrierën, të kërkojnë masa të shtuara sigurie ose të tërhiqen nga raportimi për tema të ndjeshme.

## NGACMIMI ONLINE, CYBERBULLYING DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE PRIVATE (DOXING)

Gjatë viteve të fundit, ngacmimi online, bullizmi kibernetik dhe publikimi i të dhënave private (doxing) janë shndërruar në sfida serioze për gazetaret në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto forma të dhunës digjitale jo vetëm që rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e tyre, por gjithashtu minojnë lirinë dhe pavarësinë mediatike në vend. Me rritjen e përdorimit të mjeteve dhe platformave digjitale, gazetaret gjithnjë e më shpesh bëhen shënjestër e sulmeve që synojnë t'i diskreditojnë, t'i heshtin dhe t'i frikësojnë. Ngacmimi online manifestohet përmes kërcënimeve, fyerjeve dhe formave të tjera të sjelljes së padëshiruar në hapësirën digjitale. Gazetaret në Maqedoninë e Veriut shpesh përballen me bullizëm kibernetik, i cili më së shpeshti shfaqet përmes kërcënimeve me dhunë fizike, gjuhës së urrejtjes dhe diskreditimit të integritetit të tyre profesional<sup>59</sup>. Këto sulme shpesh kanë një dimension personal dhe gjinor dhe ndikojnë negativisht në shëndetin psikologjik, vetëbesimin dhe nivelin e angazhimit të gazetares në hapësirën publike. Sulmet verbale zakonisht janë të motivuara nga stereotipe gjinore dhe synojnë diskreditimin e gazetares përmes poshtërimit dhe marginalizimit të tyre. Në sferën digjitale, kjo formë e dhunës

59 Të dhëna të marra nga intervistat dhe grupet e fokusit, si dhe nga analiza e titulluar "Ndërtimi i sistemeve mbështetëse për gratë gazetares", <https://pina.mk/8106-gradene-sistemi-za-poddrshka-na-zhenite-novinarki/>

mund të marrë përmasa shqetësuese përmes sulmeve të koordinuara në rrjet, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj presionit psikologjik dhe turpit publik. Për të përballuar këto kërcënime, nevojiten strategji gjithëpërfshirëse dhe mbështetje e fortë nga institucionet, publiku dhe shoqatat mediatike, me qëllim krijimin e një mjedisi ku gratë mund ta shprehin lirisht dhe në mënyrë të sigurt zërin e tyre. Ngacmimi seksual përbën një formë serioze të dhunës me bazë gjinore që rrezikon sigurinë dhe integritetin profesional të gazetareve në Maqedoninë e Veriut. Sipas hulumtimeve më të fundit, mbi 30% e grave në fushën e medias raportojnë se janë përballur me ngacmim seksual në vendin e punës ose në hapësirën digjitale, që përfshin komente verbale me përmbajtje seksuale, propozime të papërshtatshme dhe madje kërcënime fizike. Ky lloj dhune shpesh manifestohet nga kolegë, eprorë ose persona të panjohur në internet. Siç u përmend më herët, pasojat janë serioze – ato cenojnë mirëqenien psikologjike, i shtyjnë gratë drejt autocensurës dhe e zvogëlojnë dukshmërinë e tyre në hapësirën publike. Mungesa e mekanizmave efektivë për raportim dhe sanksionim të rasteve të tilla, si dhe frika e vazhdueshme nga hakmarrja ose humbja e vendit të punës, i nxit edhe më shumë këto dukuri.

Kërcënimet me dhunë seksuale janë një formë veçanërisht shqetësuese e ngacmimit seksual që synon gazetaret, veçanërisht ato që raportojnë për tema të ndjeshme ose jo-konvencionale, apo që kanë pozita të dukshme publike për çështje të caktuara shoqërore. Një shembull i tillë u regjistrua në shkurt të vitit 2025, kur Dragan Pavloviq Llatas – menaxher i portalit Veçer, në profilin e tij në rrjetet sociale (Facebook dhe X), brenda katër orësh publikoi një seri statusesh që synonin stafin e **IRL – Laboratori për Gazetari Hulumtuese**, duke nxitur një ortek urrejtjeje dhe thirrjesh për linçim dhe dhunë seksuale<sup>60</sup>. Kërcënimet e tilla shpesh janë të lidhura me qëllimin për të heshtur gratë dhe për të minuar punën e tyre profesionale duke shkaktuar frikë dhe ndjenjë pasigurie. Ato zakonisht mbartin një kontekst gjinor dhe synojnë të zhvlerësojnë dhe degradojnë gazetaret si në aspektin personal ashtu edhe në atë profesional. Gjatë viteve të fundit, aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile dhe asociacioneve mediatike për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave janë intensifikuar, por nevojiten ndryshime strukturore më të thella dhe mbrojtje më e fortë ligjore për të çrrënjësuar këtë formë dhune dhe për të siguruar një ambient të sigurt pune për gazetaret.

Publikimi i të dhënave private, i njohur edhe si “doxing”, përbën një taktikë të rrezikshme të zbulimit dhe keqpërdorimit të informacionit personal të gazetareve me qëllim rritjen e cënueshmërisë së tyre dhe nxitjen e dhunës ndaj tyre. Në Maqedoninë e Veriut, kjo praktikë është e pranishme dhe shpesh shënjestron gazetaret hulumtuese, të cilat i kushtojnë punën e tyre temave si korrupsioni, keqpërdorimi i pushtetit dhe të drejtat e njeriut. Përmes publikimit të të dhënave të tyre personale – adresa, numra telefoni

60 Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese, njoftim zyrtar, <https://irl.mk/od-shto-se-plashi-latas-koga-ve-pottiknuva-da-ne-siluvate-i-linchuvate/>

apo fotografi private – sulmuesit nxisin linçim publik dhe i ekspozojnë ato ndaj rreziqeve shtesë të dhunës fizike.

## DISKRIMINIMI BAZUAR NË GJINI DHE SEKS

Diskriminimi i bazuar në seks dhe gjini, si dhe abuzimi verbal, paraqesin sfida të rëndësishme për gazetaret në Maqedoninë e Veriut. Kjo ndikon në sigurinë e tyre profesionale dhe personale, si dhe në rolin e tyre në diskursin publik<sup>61</sup>. Diskriminimi i bazuar në gjini shfaqet përmes komenteve poshtëruese, nënvlerësimit, dhe **injurimit sistematik të kontributit të tyre në media**, gjë që **minon aftësinë e tyre për të kryer punën me integritet dhe liri**<sup>62</sup>. Shpesh, **gazetaret përballen me trajtim të pabarabartë** krahasuar me kolegët e tyre meshkuj, gjë që çon në **mundësi të pabarabarta për zhvillim profesional dhe karriere** dhe i vendos ato në një **pozicion të cenueshëm** në shtëpitë mediatike<sup>63</sup>. Hulumtimet e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (SPGPM) tregojnë qartë se **gazetaret në Maqedoninë e Veriut janë në një pozitë të pafavorshme**, veçanërisht sa i përket përfaqësimit të tyre në pozita drejtuese. Edhe pse gratë dominojnë në redaksi, në pozitat redaktoriale dhe veçanërisht ato të drejtorëve, **meshkujt ende mbizotërojnë**. Kjo pabarazi është rezultat i barrierave strukturore, stereotipeve dhe paragjyqimeve që kufizojnë mundësitë e grave për të avancuar në hierarkinë mediatike, pavarësisht faktit se gazetaria po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një "profesion femëror".

Për më tepër, gratë shpesh përballen me diskriminim, vlerësim të pamjaftueshëm dhe ndikim nga eprorët, gjë që e vështirëson më tej pozitën e tyre. Përveç përfaqësimit të ulët të grave në pozita kyçe vendimmarrëse, hulumtimet tregojnë gjithashtu se **ato janë më shpesh të ekspozuara ndaj mobingut, diskreditimit publik dhe formave të ndryshme të presionit** në krahasim me kolegët e tyre meshkuj. Statistikat tregojnë se 27% e gazetarëve kanë raportuar ndikim të fortë nga redaktorët, dhe 21% nga menaxherët, gjë që kufizon më tej zhvillimin e tyre profesional dhe autonominë. Këto të dhëna theksojnë nevojën për ndryshime sistematike dhe promovimin e barazisë gjinore në media, në mënyrë që gratë të marrin vendin e merituar si redaktore dhe drejtoresha dhe të jenë nxitëse të vërteta të ndryshimeve në profesion.

Paragjykimet sociokulturore ndaj grave nxisin këtë diskriminim dhe shpesh përdoren si mjet për të minimizuar ndikimin dhe zërin e tyre në vendin e punës. Gazetaret që morën pjesë në grupet e fokusit për nevojat e këtij raporti theksuan se **përballen gjithashtu me diskriminim dhe trajtim të pabarabartë për shkak të shtatzënisë**. Ka raste të gazetarëve

61 Raporti Vjetor i punës së Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2023, <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2024/05/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%BD%D0%B0-%D0%9A%D0%A1%D0%97%D0%94-%D0%B7%D0%B0-2023-%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0.pdf>

62 Raport Vlerësimi (Fillestar) i GREVIO-s për Masat Legjislative dhe të Tjera që Zbatojnë Dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) MAQEDONIA E VERIUT <https://mtsp.gov.mk/content/pdf/2023/ednakvi%20moznosti/GREVIO%20%20INF%202023%205%20FINAL%20REPORT%20MK.pdf>

63 ANALIZË E BARAZISË GJINORE NË SPORT NË MAQEDONINË E VERIUT [https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2022-11/MK-Gender\\_Equality\\_in\\_Sport-web.pdf](https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2022-11/MK-Gender_Equality_in_Sport-web.pdf)

të larguara nga puna gjatë shtatzënisë, por edhe raste kur e kanë më të vështirë të punësohen sesa gazetaret meshkuj, për shkak të supozimit se mund të planifikojnë një fëmijë. "Shembuj të tillë janë të shpeshtë, por gazetaret rrallë i raportojnë dhe rrallë flasin hapur,"<sup>64</sup>, **theksoi një pjesëmarrëse e grupit të fokusit**. Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Sindikata e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias janë të vendosur se **nuk mund të ndihmojnë nëse nuk ka denoncime dhe nëse nuk flitet hapur**<sup>65</sup>.

Stereotipat gjinorë paraqesin një **pengesë të madhe për gazetaret**, pasi ato ndikojnë në mënyrën se si gratë trajtohen, vlerësohen dhe pranohen në shoqëri e në media. Gratë shpesh përballen me supozimin se aftësitë e tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema "të rënda" ose "mashkullore" si politika, ekonomia dhe korrupsioni, janë **më pak të vlefshme ose relevante** krahasuar me kolegët e tyre meshkuj<sup>66</sup>. Këta stereotipe mbahen edhe përmes **politikave editoriale të mediave**, ku gratë kufizohen në tema që tradicionalisht konsiderohen "femërore", si familja, shëndetësia dhe kultura, si dhe tema që lidhen me barazinë gjinore. **Vënia në pikëpyetje e përditshme e kredibilitetit të tyre** çon në rritje të presionit psikologjik, gjë që më tej ul motivimin dhe mundësinë e tyre për zhvillim profesional. Përveç kësaj, në situata krize ose konflikti, **gazetaret përballen me reziqe të shtuara diskriminimi dhe sulmesh**, gjë që i bën ato edhe më të cenueshme.

## SFIDAT UNIKE ME TË CILAT PËRBALLEN GAZETARET

Gazetaret në Maqedoninë e Veriut përballen me **sfida specifike** që rrjedhin nga gjinia, angazhimi profesional dhe ekspozimi i tyre publik. Stereotipat dhe diskriminimi me bazë gjinore i vënë gratë në sferën mediatike nën presion të shtuar krahasuar me kolegët meshkuj. Nga njëra anë, si gra, ato shpesh perceptohen si **më të dobëta ose më pak të afta** për të trajtuar tema "të vështira", gjë që çon në trajtim të pabarabartë në vendin e punës, mundësi të kufizuara për avancim dhe stres shtesë. Nga ana tjetër, angazhimi i tyre profesional dhe roli publik si bartëse informacioni i bën ato **shënjestra të dukshme** për lloje të ndryshme sulmesh online dhe offline, duke përfshirë kërcënime personale, diskreditim dhe tentativa për frikësim. Lidhja midis gjinisë dhe profesionit gjithashtu krijon një sfidë të veçantë për gazetaret, në aspektin e konfliktit me pritshmëritë dhe perceptimet e shoqërisë për punën dhe rolin e tyre publik. Kjo i bën ato të ekspozuara ndaj **diskriminimit të dyfishtë**: si gra në një hapësirë publike dhe si gazetare të përkushtuara ndaj krijimit të përmbajtjes informative. Kjo dinamikë e kombinuar përshkallëzohet kur ato merren me tema të ndjeshme, si politika, korrupsioni apo të drejtat e grave. Mbulimi i këtyre temave jo vetëm që i ekspozon ato ndaj presioneve profesionale dhe politike, por edhe ndaj sulmeve direkte që shpesh janë të ngjyrosura me gjini – me komente

64 Deklaratë e një gazetaresje-redaktoreje nga një media online në Maqedoni, e cila mori pjesë në grupin e fokusit të mbajtur më 26.12.2024.

65 <https://pina.mk/8547-novinarkite-soocheni-so-diskriminatsija-i-neednakov-tretman-poradi-bremenosta/>

66 GJINIA NË MEDIA 2023: HULUMTIM MBI MËNYRËN E RAPORTIMIT TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NË TELEVISIONET KOMBËTARE, <https://isppi.ukim.edu.mk/sites/default/files/isppi/print/istrazuvački-studii/rodot-vo-mediumite-2023.pdf>

fyese për pamjen, marrëdhëniet personale apo moralin e tyre. Këto sulme mund të kenë një efekt frikësues në punën e tyre, duke i detyruar ato të tërhiqen ose të vetë-censurohen. Për më tepër, gazetaret që mbulojnë tema si korrupsioni ose të drejtat e grave janë **veçanërisht të cenueshme** ndaj rritjes së shënjestrimit. Puna e tyre, e cila nxjerr në pah padrejtësinë, shpesh i bën ato shënjestra të sulmeve nga grupe të fuqishme politike dhe ekonomike që përpiqen t'i heshtin përmes kërcënimeve ose diskreditimit publik. Sulmuesit, duke shfrytëzuar diskursin publik dhe platformat digjitale, i përforcojnë sulmet për të minimizuar imazhin e tyre dhe për të minuar besimin e publikut në punën e tyre.

## PASOJAT PSIKOLOGJIKE DHE PROFESIONALE

Një nga ndikimet më të dukshme të dhunës ndaj gazetarëve janë pasojat negative mbi shëndetin e tyre mendor. Kjo vlen veçanërisht për ato që punojnë me tema që lidhen me korrupsionin, politikën dhe të drejtat e njeriut, sidomos barazinë gjinore, ku rreziku i dhunës është rritur ndjeshëm. Presioni dhe frika nga hakmarrja shpesh çojnë në auto-censurë – një kufizim i vetë-imponuar në sasinë dhe përmbajtjen e punës së tyre, me qëllim shmangien e sulmeve apo kërcënimeve shtesë. Kështu, jo vetëm që kufizohet liria e shprehjes, por dëmtohet edhe cilësia dhe objektiviteti i punës gazetareske. Dhuna ka edhe pasoja serioze profesionale për gazetaret. Nga frika e sulmeve apo presioni i vazhdueshëm, disa prej tyre vendosin të tërhiqen nga gazetaria, veçanërisht kur institucionet nuk ofrojnë mbrojtje adekuate. Një tjetër reagim i shpeshtë është shmangia e temave të ndjeshme apo "të rrezikshme", gjë që ndikon drejtpërdrejt në funksionin informues të mediave dhe zvogëlon gamën e çështjeve të mbuluara. Në këtë mënyrë, gazetaret përballen me një goditje të dyfishtë – kufizimin e lirisë së tyre profesionale dhe diskreditimin nga ana e dhunuesve që e arrijnë efektin e tyre përmes frikësimit. Kjo zvogëlon ndikimin e tyre në industrinë mediatike dhe krijon pabarazi në qasjen ndaj temave të rëndësishme dhe debateve publike.

## PËRPJEKJET AKTUALE DHE PRAKTIKAT E MIRA PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË

Përballja me sfidat e sigurisë së gazetarëve kërkon një **qasje gjithëpërfshirëse** që përfshin aktorë lokalë dhe ndërkombëtarë në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës. Në Maqedoninë e Veriut, ashtu si në nivel global, po bëhen përpjekje të rëndësishme për të **forcuar kapacitetet dhe për të ofruar mbështetje për gazetaret** përmes iniciativave të shoqatave të gazetarëve, rrjeteve mbështetëse dhe programeve ndërkombëtare<sup>67</sup>. Për shembull, në tetor të vitit 2024, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) promovoi **Doracakun e Sigurisë për Gazetarë**<sup>68</sup> Në bashkëpunim me Prokurorinë Publike dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ky manual ka

67 E BARABARTË, rrjeti mediatik femëror, <https://ssnm.org.mk/ednakva>  
68 MKD\_ZNM\_Priracnik-za-bezbednost-na-novinari-010824-2.pdf

për qëllim të ofrojë një përgjigje të parë më efektive në rast sulmi ndaj një gazetari, si dhe një procedurë të efektshme mbrojtjeje.

Më tej, formimi i rrjetit **"E Barabartë"** në vitin 2024 është një shembull pozitiv për rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e luftës për barazinë gjinore në media. Kjo nismë bashkon gazetarë, profesionistë të medias dhe organizata me një qëllim të përbashkët – krijimin e kushteve për barazi dhe siguri për gratë në industrinë mediatike. "E Barabartë" punon në mënyrë aktive për promovimin e raportimit të ndjeshëm ndaj gjinisë, sigurimin e mbështetjes për gazetarët që përballen me diskriminim ose dhunë, si dhe avokimin për përmirësimin e kornizës legjislative dhe mekanizmave institucionalë. Përmes aktiviteteve të saj, rrjeti "E Barabartë" nxit një debat publik për rëndësinë e barazisë gjinore në media dhe thekson rolin e gazetarëve si aktorë kyç në shoqërinë demokratike. Organizimi i trajnimeve, punëtorive dhe fushatave ndërgjegjësuere kontribuon në krijimin e një mjedisi mediatik gjithëpërfshirës që njeh dhe adreson sfidat specifike me të cilat përballen gazetarët. Ky shembull tregon se me solidaritet, përpjekje të koordinuara dhe përkushtim, mund të arrihen ndryshime të rëndësishme drejt përmirësimit të të drejtave dhe sigurisë së grave në sektorin mediatik. Këto përpjekje janë me rëndësi të madhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjen e grave që përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë.

Në Maqedoninë e Veriut, shoqatat e gazetarëve luajnë një rol kyç në mbështetjen e gazetarëve. Shoqatat si Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) zhvillojnë fushata për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e gazetarëve dhe sigurojnë mekanizma për mbështetje ligjore dhe mbrojtje. Ato përfaqësojnë interesat e gazetarëve përpara institucioneve dhe kërkojnë sanksionimin e dhunës dhe kërcënimeve. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe rrjete mbështetëse për gratë gazetarë që ofrojnë platforma për shkëmbimin e përvojave, forcimin e solidaritetit të tyre dhe mobilizimin e shoqërisë për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të medias. Në nivel ndërkombëtar, praktikat dhe modelet e mira për mbrojtjen e gazetarëve përfshijnë një sërë aktiviteteve që janë të zbatueshme edhe në nivel lokal. Organizata si Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (IFJ) dhe Reporterët pa Kufij (RWB) ofrojnë standarde dhe udhëzime për mbrojtjen e gazetarëve, përfshirë programet për gratë gazetarë. Modelet e mbrojtjes kolektive, si rrjetet e reagimit të hershëm ndaj kërcënimeve dhe platformat për raportimin e incidenteve, janë dëshmuar të jenë efektive në forcimin e sigurisë së grave që janë aktive në hapësirën publike. Këto modele inkurajojnë institucionet dhe organizatat mediatike të marrin një rol proaktiv në mbrojtjen e gazetarëve. Trajnimet për sigurinë e gazetarëve janë një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të rezistencës së tyre ndaj dhunës dhe kërcënimeve. Këto trajnime shpesh përfshijnë sigurinë fizike, vetëmbrojtjen dhe teknikat për t'u përballur me situata stresuese<sup>69</sup>. Në Maqedoninë e Veriut, si dhe në rajon, organizatat e gazetarëve dhe iniciativat qytetare

69 Ndërtimi i sistemeve mbështetëse për gazetarët <https://pina.mk/8106-gradene-sistemi-za-poddrshka-na-zhenite-novinarki/>

organizojnë trajnime që i ndihmojnë gratë të zhvillojnë aftësitë për identifikimin dhe refuzimin e rreziqeve potenciale.

Përveç sigurisë fizike, fokusi është edhe te shëndeti mendor, me qëllim që të sigurohet mbështetje emocionale dhe strategji adekuate për përballimin e përvojave traumatike. Siguria digjitale është një aspekt kyç i mbrojtjes për gazetaret, duke pasur parasysh rritjen e ngacmimeve online dhe sulmeve kibernetike. Trajnimet për sigurinë digjitale përfshijnë mjete praktike për mbrojtjen e identitetit online, përdorimin e sigurt të platformave të komunikimit dhe parandalimin e sulmeve kibernetike. Organizatat mediatike bashkëpunojnë me ekspertë për t'u mundësuar gazetarëve qasje në softuerë sigurie, komunikim të kriptuar dhe teknika për uljen e rreziqeve digjitale. Këto trajnime u mundësojnë gazetarëve të mbeten aktive dhe të angazhuara, edhe në kushte të kërcënimeve të shtuara.

## FAKTORËT POLITIKË DHE INSTITUCIONALE

**Presionet politike dhe shënjestrimi i gazetarëve** paraqesin një sfidë serioze për lirinë e medias dhe mbrojtjen e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut. Këto fenomene jo vetëm që dëmtojnë integritetin e punës gazetareske, por gjithashtu minojnë besimin e publikut dhe funksionimin demokratik të shoqërisë<sup>70</sup>. Gratë që publikisht kritikojnë strukturat qeverisëse ose ngrenë çështje të korrupsionit, të drejtave të njeriut dhe padrejtësive sociale, shpesh ekspozohen ndaj sulmeve dhe presioneve politike. Këto sulme mund të shfaqen si diskreditime publike, kërcënime, presione për censurë, apo edhe procedime gjyqësore që synojnë t'i frikësojnë dhe t'i heshtin.

Ndikimet politike mbi mediat shpesh përdoren për të manipuluar opinionin publik, dhe gazetaret, për shkak të pozicionit të tyre specifik, janë të cenueshme ndaj sulmeve të synuara që vënë në pikëpyetje integritetin e tyre personal dhe profesional. Këto sulme jo vetëm që ndikojnë në sigurinë e tyre personale, por gjithashtu minojnë besueshmërinë e tyre si zëdhënës të interesit publik. Dështimet institucionale në trajtimin e dhunës dhe ngacmimit përkeqësojnë më tej situatën për gazetaret. Pavarësisht ekzistencës së legjislacionit dhe mekanizmave për mbrojtje nga dhuna, në praktikë ka mangësi të theksuara në zbatimin e tyre. Gazetaret që përballen me kërcënime, ngacmime ose sulme fizike rrallë marrin mbështetje në kohë dhe efektive nga institucionet. Shpesh, inercia institucionale ose përkushtimi i pamjaftueshëm ndaj zbatimit të ligjit krijon një kulturë pandëshkueshmërie, e cila inkurajon më tej sulmuesit. Nevojitet një forcim sistematik i institucioneve dhe sigurimi i mbrojtjes reale, me qëllim që të kapërcehet reagimi i pamjaftueshëm institucional dhe të krijohet një mjedis i sigurt për punonjëset e medias.<sup>71</sup>

70 DISKRIMINIMI DHE GJUHA E URREJTJES NË MEDIA DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK, <https://ima.mk/wp-content/uploads/2024/12/diskriminaczi%D1%98ata-i-govorot-na-omraza-vo-mediumite-i-%D1%98avnata-komunikaczi%D1%98a-analizi.pdf>

71 Nga normalizimi te vetëcensura Analizë e ngacmimeve online ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, [https://www.osce.org/files/f/5/526988\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/5/526988_0.pdf)

# VIII Përfundime

Gazetaret përballen me një gamë të gjerë kërcënimesh dhe sulmesh, duke përfshirë dhunën fizike dhe seksuale, ngacmimin online, diskriminimin dhe presionet politike. Këto shkaktohen nga faktorë të shumtë, përfshirë dimensionet shoqërore, politike, ekonomike dhe teknologjike. Shkaqet e këtyre kërcënimeve janë thellësisht të rrënjosura në kontekstin shoqëror, ku normat patriarkale dhe stereotipet gjinorë krijojnë një atmosferë armiqësore për gratë në diskursin publik. Ato shpesh janë shënjestër e diskreditimit të seksualizuar, ngacmimeve verbale dhe sulmeve që synojnë pamjen, seksin apo gjininë e tyre.

Nga ana tjetër, ndikimet politike luajnë një rol të rëndësishëm në gjenerimin e presioneve ndaj gazetarëve, veçanërisht kur ata hetojnë çështje me interes publik që përfshijnë korrupsionin dhe abuzimin me pushtetin. Në raste të tilla, gazetaret ekspozohen ndaj kërcënimeve serioze nga individë dhe struktura me motive politike, gjë që përkeqëson më tej sigurinë e tyre profesionale.

Pasojat e këtyre kërcënimeve janë të thella dhe komplekse. Së pari, ato shkaktojnë trauma psikologjike dhe ankth te gazetaret e prekura, gjë që mund të çojë në vetë-censurë, braktisje të detyrave profesionale ose largim të plotë nga profesioni. Së dyti, dhuna ndaj gazetarëve jo vetëm që rrezikon gazetaret individuale, por ka edhe një ndikim thelbësor më të gjerë në lirinë e medias dhe pluralizmin në shoqëri. Kur gazetaret heshten përmes dhunës ose frikësimit, prishet barazpesha e zërave dhe perspektivave të ndryshme në hapësirën mediatike. Pluralizmi mediatik është thelbësor për një shoqëri demokratike, pasi ai mundëson një debat publik të informuar dhe shkëmbim idesh. Kur zërat e grave heshten, publiku privohet nga pikëpamjet, përvojat dhe analizat e tyre, gjë që çon në një diskurs të njëanshëm dhe dominim të grupeve apo interesave të caktuara. Efektet e kësaj gjendjeje mbi debatin publik dhe pjesëmarrjen demokratike janë afatgjata.

Dhuna ndaj gazetarëve, si pjesë e një kulture më të gjerë frikësimi, është strukturore dhe minon besimin te mediat dhe dekurajon gratë e tjera të marrin pjesë në hapësirën publike. Kur debatet publike kufizohen nga frika dhe presionet, procesi demokratik bëhet i cenueshëm ndaj manipulimeve dhe korrupsionit. Mjedisi mediatik që toleron ose nuk reagon siç duhet ndaj dhunës kundër gazetarëve minon besueshmërinë

e mediave si "pushteti i katërt" dhe zvogëlon aftësinë e tyre për të mbajtur autoritetet përgjegjëse. Prandaj, trajtimi i dhunës ndaj gazetareve është një imperativ për mbrojtjen e lirisë së medias, por edhe për forcimin e demokracisë dhe drejtësisë në shoqëri.

Faktorët ekonomikë gjithashtu ndikojnë në cenueshmërinë e tyre. Pavarësia e pamjaftueshme financiare e mediave mund të çojë në presione editoriale ose në kushte për vetë-censurë. Hulumtimet e SPGPM-së dhe analizat përkatëse tregojnë se gratë janë të përfaqësuara shumë pak si menaxhere dhe pronare në industrinë mediatike në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse gratë janë më të shumta në redaksi dhe shpesh konsiderohen si "forca punëtore" në media, në pozitat më të larta – drejtorë, menaxherë dhe pronarë – dominojnë burrat. Për shembull, sipas të dhënave, diferenca tek menaxherët/drejtorët është 47 në favor të burrave, ndërsa sa i përket pronësisë, ka vetëm një grua-pronare të medias në vend<sup>72</sup>. Kur bëhet fjalë për pozitat redaktoriale, edhe pse ka media ku gratë janë kryeredaktore (si MIA dhe RTM), në nivel industrial, burrat janë më të shumtë edhe në këto funksione. Kjo konfirmon se pabarazia gjinore është më e theksuar pikërisht në pozitat ku merren vendimet kyçe.

Në lidhje me mediat si punëdhënës, mbështetja që ofrojnë është shpesh e kufizuar. Disa redaksi kanë politika bazë për parandalimin e diskriminimit apo ngacmimeve, por rrallë zbatohen masa strukturore si protokolle sigurie apo programe për shëndetin mendor. Hulumtimet tregojnë se në shumë raste, shtëpitë mediatike nuk i përgatisin mjaftueshëm punonjësit e tyre për t'u përballur me stresin dhe rreziqet e lidhura me punën e tyre. Së fundi, reagimi i dobët ligjor ndaj autorëve forcon ndjenjën e pandëshkueshmërisë dhe krijon një precedent të rrezikshëm për rastet e ardhshme të dhunës. Përgjigjet ndaj këtyre kërcënimeve, edhe pse ekzistojnë, janë ende joefikase dhe të pamjaftueshme. Ligjet ekzistuese që mbrojnë gazetarët nuk zbatohen gjithmonë siç duhet, dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes janë të papërshtatshëm ose të papërgatitur për t'iu përgjigjur nevojave specifike të grave gazetare. Këto mangësi kërkojnë reformë institucionale dhe mbështetje prioritare.

72 Gratë forcë punëtore, burrat në pozita vendimmarrëse pamja më e shpeshtë në media <https://hezavisen.mk/zhenite-rabotna-sila-mazhite-na-odluchuvachki-pozicii-najchesta-slika-vo-mediumite/>

# IX Rekomandime

## — REFORMA LIGJORE DHE POLITIKE

### FORCIMI I LIGJEVE EKZISTUESE DHE SIGURIMI I ZBATIMIT TË NDJESHËM GJINOR

Është e domosdoshme të rishikohen dhe forcohen ligjet ekzistuese që mbrojnë gazetarët dhe gratë, duke adresuar shprehimisht format specifike të dhunës dhe diskriminimit me të cilat përballen gratë gazetare.

Duke pasur parasysh rastet e shpeshta të dhunës me bazë gjinore ndaj gazetarëve, veçanërisht në hapësirën online, institucionet kompetente duhet të shqyrtojnë mundësinë e futjes së një forme të kualifikuar të veprës penale të ngacmimit seksual, të parashikuar në Kodin Penal, me dënime më të ashpra kur vepra kryhet ndaj gazetarëve gjatë kryerjes së detyrave profesionale. Ky ndryshim do të njihte rolin dhe cenueshmërinë e veçantë të gazetarëve, veçanërisht të grave gazetare si bartëse të informacionit publik, dhe do të kontribuonte në një mbrojtje më të fortë nga kërcënimet, fyerjet dhe ngacmimet që synojnë heshtjen ose diskreditimin e tyre. Për më tepër, do të dërgonte një mesazh të qartë për zero tolerancë ndaj sulmeve me motive gjinore ndaj punonjëseve të medias.

Gjithashtu, duhet të sigurohet zbatim i duhur i ligjeve në praktikë, me fokus të veçantë në hetimin efektiv të rësve dhe shqiptimin e sanksioneve të përshtatshme.

Zhvillimi i Mekanizmave për Parandalimin e Abuzimeve Online dhe Llogaridhënie: Është e nevojshme të zhvillohen mekanizma efikasë për parandalimin e dhunës online dhe për sigurimin e llogaridhënies së rrjeteve sociale dhe platformave të tjera digjitale. Kjo përfshin vendosjen e procedurave për heqjen e shpejtë të përmbajtjeve fyese dhe sanksionimin e përdoruesve që përfshihen në ngacmim kibernetik. Gjithashtu, është e nevojshme bashkëpunimi me platformat digjitale për zhvillimin e mjeteve për mbrojtjen e gazetarëve nga sulmet online dhe për identifikimin e heqjen e profileve të rreme dhe botëve që shpërndajnë dezinformata dhe përmbajtje shqetësuese.

## — PËRMIRËSIME INSTITUCIONALE

### TRAJNIME PËR POLICINË DHE ORGANET GJYQËSORE MBI KËRCËNIMET ME BAZA GJINORE

Është e domosdoshme të zbatohen **programe të specializuara trajnimi** për oficerët e policisë dhe organet gjyqësore, me qëllim që të përballen me kërcënimet dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë gazetare. Ky trajnim duhet të përfshijë tema si **ndjeshmëria gjinore, krimet kibernetike**, aspektet psikologjike të dhunës dhe të drejtat e gazetarëve. Qëllimi është të përmirësohet kuptimi i tyre për kompleksitetin e këtyre rasteve dhe të sigurohet një reagim efektiv dhe në kohë ndaj denoncimeve të dhunës.

## — KRIJIMI I NJËSIVE TË REAGIMIT DHE MBROJTJES PËR GRATË GAZETARE TË RREZIKUARA

Duhet të shqyrtohet mundësia e krijimit të **njësive të specializuara** brenda policisë dhe prokurorisë, të cilat do të jenë përgjegjëse për hetimin dhe zgjidhjen e rasteve të dhunës ndaj grave gazetare. Këto njësi duhet të përbëhen nga profesionistë të trajnuar, me ekspertizë në fushën e dhunës me bazë gjinore, përfshirë atë digjitale dhe liritë e medias. Detyra e tyre do të jetë të sigurojnë një reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj kërcënimeve, të mbrojnë gazetaret e prekura dhe t'i sjellin autorët para drejtësisë.

Për më tepër, duhet të zhvillohen **programe edukative** në arsimin e mesëm dhe të lartë, veçanërisht në studimet e gazetarisë, për sigurinë digjitale, njohjen dhe trajtimin e dhunës online dhe teknikat e vetëmbrojtjes.

### MEKANIZMA MBËSHTETËS

Mbështetje Psikologjike dhe Ligjore për Gazetaret e Prekura: Është e nevojshme të ofrohen shërbime të qasshme dhe të disponueshme për **këshillim psikologjik, ndihmë ligjore** dhe mbështetje tjetër të nevojshme për gratë gazetare që përballen me dhunë dhe kërcënime, duke përfshirë vendosjen e linjave telefonike për ndihmë emergjente. Është thelbësore të sigurohet **konfidencialiteti dhe diskrecioni** në ofrimin e këtyre shërbimeve, me qëllim që të inkurajohen gratë gazetare të kërkojnë ndihmë pa frikë nga stigmatizimi apo hakmarrja. Përveç kësaj, **ndihma ligjore** për gratë gazetare është thelbësore për mbrojtjen dhe fuqizimin e tyre. Programet e mbështetjes ligjore përfshijnë qasjen në këshilla ligjore, paraqitjen e padive dhe përfaqësimin në gjykata, me qëllim sanksionimin e shkelësve. Kjo mbrojtje ligjore forcon besimin e gazetarëve se mund të kërkojnë ndihmë dhe se institucionet

do t'i mbrojnë<sup>73</sup>. Duke integruar mbështetjen ligjore, digjitale dhe psikologjike, krijohet një **sistem gjithëpërfshirës** që mund të përballet në mënyrë efikase me sfidat e dhunës dhe kërcënimeve me të cilat përballen gratë gazetare.

Këto shërbime ofrohen pjesërisht nga shoqatat e gazetarëve dhe punonjësve të medias, tek të cilat gazetaret kanë më shumë besim. Prandaj, është e rëndësishme që shteti të sigurojë mbështetje financiare për këto shoqata. Gjithashtu, gazetaret duhet të përdorin qendrat ekzistuese të këshillimit dhe klinikat ligjore që tashmë ofrojnë shërbime të specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Për më tepër, Ligji për Ndhimën Juridike Falas duhet të ndryshohet në mënyrë që të mundësojë ndihmë juridike parësore dhe dytësore për të gjitha viktimat e dhunës me bazë gjinore, pavarësisht gjendjes së tyre financiare. Kjo do të ofronte mbështetje ligjore edhe për gazetaret që janë përballur me dhunë me bazë gjinore.

Nxitja e solidaritetit dhe mjediseve të punës të ndjeshme ndaj gjinisë në organizatat mediatike: Është e nevojshme të promovohen politika dhe praktika në organizatat mediatike që mbështesin barazinë gjinore dhe krijojnë një mjedis pune të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Kjo përfshin miratimin e kodeve të sjelljes që ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, si dhe vendosjen e procedurave për raportimin dhe zgjidhjen e rasteve të tilla. Përveç kësaj, organizatat mediatike duhet të inkurajojnë punonjësit e tyre të marrin pjesë në trajnime për ndjeshmërinë gjinore dhe sigurinë, përfshirë sigurinë në internet, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sfidat me të cilat përballen gratë gazetare dhe zhvillimin e aftësive për përballimin e kërcënimeve.

Mediat duhet të marrin një rol proaktiv duke krijuar mjedise pune të sigurt, duke ofruar trajnime të rregullta dhe duke futur mekanizma për raportimin dhe zgjidhjen e rasteve të ngacmimeve dhe dhunës<sup>74</sup>.

## RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK DHE AVOKIMI

Fushata publike për adresimin e normave shoqërore dhe dhunës me bazë gjinore: Është e nevojshme të zbatohen **fushata publike ndërgjegjësuese** për rëndësinë e lirisë së medias dhe sfidat me të cilat përballen gratë gazetare. Këto fushata duhet të kenë si objektiv **sfidimin e normave shoqërore dhe stereotipeve gjinore** që kontribuojnë në dhunë dhe diskriminim ndaj grave në media. Është thelbësore të promovohen **shembuj pozitivë të grave gazetare** që janë të suksesshme dhe me ndikim në punën e tyre, si dhe të nxitë dialogu për barazinë gjinore dhe rëndësinë e raportimit të lirë dhe të pavarur.

Përfshirja e organizatave qytetare dhe medias në përpjekjet avokuese: Duhet të inkurajohet **bashkëpunimi midis qeverisë, organizatave qytetare dhe medias** në përpjekjet

73 Doracak i sigurisë për gazetarët gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë, [https://www.osce.org/files/MAK%20Guidebook%20Safety%20on%20Journalists\\_FINAL.pdf](https://www.osce.org/files/MAK%20Guidebook%20Safety%20on%20Journalists_FINAL.pdf)

74 Informacione të marra përmes grupeve të fokusit dhe intervistave me gazetarë dhe redaktorë mediash.

e përbashkëta për promovimin e sigurisë së grave gazetare dhe forcimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kjo përfshin formimin e partneriteteve për zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese, organizimin e konferencave dhe seminareve për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, si dhe monitorimin e rasteve të dhunës dhe presioneve ndaj gazetarëve dhe avokimin për mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre.

Së fundi, është e domosdoshme të punohet për **rritjen e ndërgjegjësimit publik** për rëndësinë e lirisë së medias dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë gazetare. Partneritetet e shoqatave profesionale të gazetarëve me shoqatat qytetare të grave dhe mediat, si dhe diskutimet publike, do të ndihmojnë në ndryshimin e qëndrimeve shoqërore dhe uljen e paragjyqimeve gjinore. Me përpjekje të përbashkëta nga institucionet qeveritare, sektori civil dhe partnerët ndërkombëtarë, Maqedonia e Veriut mund të bëjë hapa të rëndësishëm drejt mbrojtjes së grave në profesionin mediatik dhe forcimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

**Titulli Origjinal**  
Sfidat dhe Përparimi: Siguria e Gazetareve  
në Maqedoninë e Veriut 2024

**Autorët**  
Milan Spirovski  
Verçe Todorovska Kostovska

Rishikuar dhe Redaktuar nga  
Neda Çalovska Dimovskaa

Përkthimi nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe  
Ferikan Iljazi

**Botues**  
Shoqata e Pavarur e Gazetarëve  
nga SerbiaShkup, viti 2025



Fotografia në faqen e parë  
Andrija Vukelić

**Dizajni**  
comma.rs



Kjo botim është përgatitur me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.